



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 64, QARKU BERAT, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 10.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr. 64, Qarku Berat, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr.1566 prot., datë 20.03.2019, i është drejtuar Prefektit të Qarku Berat, duke kërkuar paraqitjen e listës së plotë të objekteve brenda territorit të Qarkut Berat që përmbushin kriteret e neneve 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, dhe Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 9.04.2015. për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për pesë (5) Zonat e Administrimit Zgjedhor.

Prefekti i Qarkut Berat, me shkresën nr. 2352 prot, datë 15.04.2019, i ka paraqitur KQZ-së propozimet për ambiente të cilat mund të shërbejnë si Vende të Numërimit të Votave për seicilën nga VNV-të e Qarkut Berat.

Ambienti i propozuar për krijimin e VNV-së për ZAZ-në Nr. 64, Qarku Berat, është:



Nr.299 i Vendimit Data 10.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e vendimit

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.64, Qarku Berat,
për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

1. Qendra Kulturore "Margarita Tutulani", Berat me sipërfaqe rreth 200 m²;

Ky ambient, ka qenë Vend i Numërimit të Votave edhe në zgjedhjet e mëparshme, dhe ndodhet brenda territorit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizmit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit",

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

V E N D O S I

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 64, Qarku Berat, në Qendrën Kulturore "Margarita Tutulani", Bashkia Berat.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement ZGURI Kryetar

Denar BIBA Zëvendëskryetar

Bledar SKËNDERI Anëtar

Edlira JORGAQI Anëtare

Rezarta BITRI Anëtare



Nr.299 i Vendimit Data 10.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e vendimit

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.64, Qarku Berat,
për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.